

MEMORANDUM MIRËKUPTIMI

NDËRMJET

DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË PRONËSISË INDUSTRIALE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

DHE

ZYRËS SË PRONËSISË INDUSTRIALE TË REPUBLIKËS ÇEKE

Drejtoria e Përgjithshme e Pronësisë Industriale e Republikës së Shqipërisë (DPPI) dhe Zyra e Pronësisë Industriale të Republikës Çeke, në vijim të referuara (ZPI) si “Zyrat” duke:

KONSIDERUAR rëndësinë e pronësisë industriale për zhvillimin e ekonomisë, promovimin e inovacionit dhe shkëmbimin e teknologjisë,

NJOHUR nevojën për të promovuar dhe përmirësuar inovacionin dhe për të forcuar sistemet kombëtare të pronësisë industriale, me qëllim garantimin e administrimit të duhur, mbrojtjen dhe përdorimin e të drejtave të pronësisë industriale,

KUPTUAR nevojën për bashkëpunim më të gjerë bilateral ndërmjet Zyrave për të forcuar sistemet e pronësisë industriale ekzistuese duke krijuar një mekanizëm për të patur shkëmbim të rregullt të informacionit dhe të praktikave më të mira dhe për të ndërmarrë së bashku trajnime dhe aktivitete të tjera bashkëpunuese,

DËSHIRUAR nxitjen e bashkëpunimit ndërmjet Zyrave, me qëllim promovimin e shkëmbimeve ekonomike dhe teknologjike,

bien dakord si më poshtë:

Neni 1 **Qëllimi**

Qëllimi i këtij Memorandumi Mirëkuptimi është të krijojë një bazë për bashkëpunimin midis Zyrave në fushën e pronësisë industriale, në përputhje me përgjegjësitë e zyrave në këtë fushë.

Zyrat planifikojnë të bashkëpunojnë në çështje që lidhen me përfitim dhe mbrojtjen e të drejtave të pronësisë industriale, në sistemet respektive ligjore kombëtare.

Neni 2

Fushat e Bashkëpunimit

Bashkëpunimi ndërmjet Zyrave do të mbulojë kryesisht fushat e mëposhtëme:

1. Shkëmbimin e informacionit mbi legjislacionin në fushën e pronësisë industriale (PI) dhe reflektimet për përmirësimin e tij;
2. Shkëmbimin e publikimeve në fushën e PI-së;
3. Bashkëpunimin në programet e trajnimit në lidhje me pronën industriale;
4. Bashkëpunim në fushën e procesimit të informacionit të patentave dhe shërbimeve ndaj publikut;
5. Organizimin e seminareve, workshop-eve dhe tryezave të rrumbullakëta rreth rolit të PI-së në inovacionin dhe rritjen ekonomike;
6. Bashkëpunim në ngritjen e kapaciteteve në procesin e ekzaminimit dhe grantimit të pronësisë industriale nga Zyrat;
7. Bashkëpunim dhe shkëmbim e praktikave të përbashkëta ndërmjet Zyrave, në lidhje me procesimet e kompjuterizuara të aplikimeve, raportet e kërkimit, procedurat e ekzaminimit, etj;
8. Trajnimin e stafit të Zyrave;

Neni 3

Pikat e Kontaktit

Zyrat do të ngarkojnë respektivisht pikat e kontaktit, për të monitoruar dhe vlerësuar bashkëpunimin e këtij Memorandumi Mirëkuptimi.

Neni 4

Legjislacioni dhe Marrëveshjet Ndërkombëtare

Ky Memorandum Mirëkuptimi nuk shkakton të drejta dhe detyrime ligjore detyruese për Zyrat.

Ky Memorandum Mirëkuptimi, nuk ndikon në të drejtat dhe detyrimet e Palëve që rrjedhin nga çdo marrëveshje ekzistuese ose e ardhshme dypalëshe dhe shumëpalëshe, ose në të cilën çdo Palë është anëtare.

Në këtë Memorandum Mirëkuptimi, asgjë nuk do të kuptohet si palë e detyrueshme për të bërë ndryshime në ligjet dhe rregulloret aktuale ose për t'u bashkuar me ndonjë marrëveshje ndërkombëtare.

Neni 5

Shpenzimet

Përfundimi para kohe i këtij Memorandumi Mirëkuptimi nuk do të ndikojë në përmbushjen e ndonjë bashkëpunimi të pranuar sipas programeve të miratuara të punës, përveçse kur bashkarisht është rënë dakord ndryshe nga Zyrat.

Neni 6

Dispozita përfundimtare

Ky Memorandum Mirëkuptimi do të hyjë në fuqi ditën e nënshkrimit të tij dhe do të ketë një kohëzgjatje prej pesë (5) vitesh, të ripërtëritshme për periudha shtesë me kohëzgjatje të njëjtë objekt i marrëveshjes së ndërsjelltë të Zyrave.

Ky Memorandum Mirëkuptimi mund të ndryshohet me marrëveshje të përbashkët ndërmjet Zyrave, formalizuar në një shkëmbim dokumentesh duke specifikuar datën e hyrjes në fuqi të ndryshimeve.

Secila Zyrë mund ta përfundojë këtë Memorandum Mirëkuptimi në çdo kohë, duke i bërë Zyres tjetër njoftim me shkrim të paktën tre (3) muaj përpara datës së përfundimit të saj.

Përfundimi para kohe i këtij Memorandumi Mirëkuptimi nuk do të ndikojë në përmbushjen e ndonjë bashkëpunimi të pranuar sipas programeve të miratuara të punës, përveçse kur bashkarisht është rënë dakord ndryshe nga Zyrat.

Nënshkruar, më...28.../01.../2025, në tre origjinalë, në gjuhën Shqip, gjuhën Çeke dhe gjuhën Angleze. Në rast të ndonjë mosmarrëveshjeje, do të mbizotëroje teksti në gjuhën Angleze.

Në emër të:

Drejtoria e Përgjithshme të Pronësisë
Industriale të Republikës së Shqipërisë

(DPPI)

Drejtor i Përgjithshëm Komanduar

Znj. Maria SOLIS KAPEDANI



Në emër të:

Zyrës së Pronësisë Industriale të
Republikës Çeke

(ZPI)

President

Z. Josef KRATOCHVÍL

